**VENDIM EKSTRAKT**

**Për kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120 pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar (kur nuk plotësohet afati i parashkrimit)**

Ankuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me katër ankesa në të cilat ngre pretendime ndaj magjistratit me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar. Ankesat janë bashkuar për shqyrtim pasi lidhen me të njëjtat fakte dhe i drejtohen të njëjtit magjistrat.

Ankuesi kundërshton vendimin datë 09.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, i cili ka marrë formë të prerë më 08.01.2015. Me këtë vendim është pranuar padia dhe është vendosur detyrimi i ankueses dhe i bashkëshortit të saj të ndjerë për të liruar dhe dorëzuar një sipërfaqe prej 700 $m^2$ tokë arë, mbi të cilën ishte kryer ndërtim pa leje. Ankuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe se vendimmarrja është e padrejtë, duke ngritur gjithashtu pretendime për bashkëpunim të gjyqtarit me ekspertin e çështjes. Në një nga ankesat, ajo ka kërkuar pezullimin dhe shtyrjen e veprimeve përmbarimore deri në përfundimin e proceseve të tjera që lidhen me të njëjtën çështje.

Në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se ankesa për t'u pranuar për shqyrtim dhe për të vijuar me verifikimin dhe/ose hetimin disiplinor duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara shprehimisht nga pika l, shkronjat "a" deri "dh" të këtij neni. Konstatimi i mos përmbushjes së njërit ose më shumë prej këtyre kritereve passjell arkivimin e ankesës.

Referuar kushteve të pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, rezulton se ajo është paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120 pika 1, shkronja "a" të këtij ligji, pasi përmban gjeneralitetet dhe adresën e ankuesit, përshkruhen rrethanat dhe faktet që pretendohen të kenë ndodhur si dhe përmban emrin, mbiemrin dhe gjykatën pranë së cilës ushtrojnë funksionin e tyre magjistratët.

Në përmbajtje të ankesës konstatohet se pretendimet e ngritura i referohen fakteve që lidhen me vendimin gjyqësor i cili ka marrë formë të prerë më datë 08.01.2015.

Neni 117 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Kur ankesa paraqitet pas kalimit të këtej afati, kohës së kryerjes së shkeljes së pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk vijon me shqyrtimin e saj për shkak të parashkrimit. Në rastin konkret, nga përmbajtja e ankesave nuk rezultojnë të dhëna që të justifikojnë zgjatjen e afatit të parashkrimit. Pretendimet e ankuesit lidhen me vendimmarrjen e vitit 2014, e cila ka marrë formë të prerë në vitin 2015, ndërsa ankesat janë paraqitur gjatë viteve 2022 dhe 2023.

Për rrjedhojë, ankesat nuk plotësojnë kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120 pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ndaj nuk mund të vijohet me analizën e kritereve të tjera të pranueshmërisë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 117, nenin 120, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 121, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 214 të ligjit nr. 115/2016” Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

VENDOSA

- Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga ankuesi, ndaj magjistratit.
- Në zbatim të nenit 121, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ky vendim t’i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.
- Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 (një) jave nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.